



AKADEMIA E SIGURISË
SENATI

Nr. 185/Prot.

Tiranë më 29 janar 2016

16
Nr. 17. Prot

VENDIM Nr. 14

Senati i Akademisë së Sigurisë, i mbledhur sot më datën 29.01.2016, pasi diskutoi rreth projekt-strukturës së Akademisë së Sigurisë dhe ndryshimeve në statut,

VENDOSI:

1. Riorganizimin e Akademisë së Sigurisë në dy njësi kryesore:
 - a. Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit.
 - b. Kolegji profesional i lartë "Kolegji i Policisë".
2. Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit të ketë në përbërje të tij njësitë bazë të strukturuar si më poshtë:
 - a. Departamenti i Formimit të Përgjithshëm.
 - b. Departamenti i Formimit Profesional & Juridik
 - c. Departamenti i Zhvillimit të vazhdueshëm.
 - d. Departamenti i Hetimit të Krimeve.
 - e. Qendra e Kërkimeve Shkencore
3. Kolegji profesional i lartë "Kolegji i Policisë" të ketë në përbërje të tij njësitë bazë të strukturuar si më poshtë:
 - f. Departamenti i Policimit të Përgjithshëm.
 - g. Departamenti i Aftësimit Policor Operacional
4. Miratimin e ndryshimeve në statutin e Akademisë së Sigurisë, si më poshtë:

Neni 5, Struktura, pika "1",
të ndryshohet si më poshtë:

 1. Struktura e AS-së përbëhet nga:
 - a) Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit,
 - b) Kolegji profesional i lartë "Kolegji i Policisë".

Neni 10, Senati Akademik, pikat "4", "5" dhe "6", të ndryshohen si më poshtë:

 4. Senati përbëhet nga nëntë anëtarë, personel akademik dhe studentë, të cilët zgjidhen për një mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e senatit, personel akademik, i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor".
 5. Shfuqizohet si pikë.
 6. Përbërja e senatit akademik:
 - a) rektori/drejtori,

- b) pesë anëtarë nga njësia kryesore,
- c) d) dy anëtarë nga kolegji profesional i lartë,
- e) një anëtar nga studentët.

Neni 11, Funksionet e Senatit Akademik, paraqiten, si më poshtë:

- 1) Garanton autonominë e institucionit, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve.
 - 2) Propozon planin strategjik të zhvillimit të Akademisë së Sigurisë.
 - 3) Miraton statutin e Akademisë së Sigurisë me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit.
 - 4) Harton strukturën e përgjithshme të Akademisë së Sigurisë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet.
 - 5) Miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut.
 - 6) Miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre.
 - 7) Propozon mbylljen dhe riorganizimin e njësive përbërëse të Akademisë së Sigurisë, si dhe ndarjen ose bashkimin e tyre.
 - 8) Miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të Akademisë së Sigurisë mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit.
 - 9) Miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore.
 - 10) Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë së linjës.
 - 11) Zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit.
 - 12) Miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të Akademisë së Sigurisë.
 - 13) Garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në Akademinë e Sigurisë.
 - 14) Krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik.
 - 15) Organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare.
5. Ndryshimet e mësipërme të dërgohen për miratim në strukturat përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kryetari i Senatit
Bilbil MEMAJ



Tiranë, 29 janar 2016